

Ta mbrojmë lëkurën



Suva

Postfach, 6002 Luzern, Nr. tel. 058 411 12 12

Porosia: www.suva.ch/88360.sq, numri i publikimit : 88360.sq



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Finanziert durch die EKAS
www.ekas.ch

suva

Mbrojta e duarve – veprohet kështu

E rëndësishme: shmangni kontaktin me sapunë agresivë, detergjentë pastrimi, lubrifikantë, bojëra flokësh, epoksidë dhe tretës.

1 Lyhuni me krem lëkure mbrojtës

- Para se të filloni punën, pas pushimit dhe pasi të keni larë duart
- Zgjedhni një krem mbrojtës të përshtatshëm me llojin e punës (p. sh. rezistent ndaj ujit ose ndaj vajit)
- Përdorni krem lëkure mbrojtës pa konservantë dhe pa aroma

2 Vishni doreza

- Kur keni punë me ujë, me sende të lagështa, sende me majë dhe të mprehta si dhe me kimikate
- Zgjedhni doreza të përshtatshme me llojin e punës (p. sh. që janë rezistente ndaj ujit, ndaj shpimeve dhe shkyerjeve, ndaj kimikateve)
- Zgjedhni masën e duhur: dorezat duhet të rrijnë mirë në duar
- Mos përdorni doreza lateksi të pudrosura
- Kur i mbani dorezat veshur për një kohë të gjatë dhe djersiteni: vishni doreza pambuku poshtë dorezave të punës
- Në rast alergjie: për t'u mbrojtur ndaj alergjentëve vishni doreza që jua ka këshilluar mjeku/mjekja

3 Pastrimi i duarve

- Mos i lani duart shpesh
- Përdorni ujë të vakët, jo të nxehtë
- Përdorni sapun të butë me vlerë pH-si 5,5
- Shpëllani mirë duart dhe hapësirën mes gishtave dhe thajini mirë me peshqir të butë

4 Kujdesi ndaj duarve

- Gjatë pushimit dhe pas punës lyejini duart shpesh me krem trajtues
- Përdorni kremëra trajtues pa konservantë dhe pa aroma
- Mos harroni të lyeji edhe majat e gishtave, hapësirat mes gishtave dhe kyçet

Doreza të përshtatshme, kremëra mbrojtës dhe trajtues si dhe detergjentë pastrimi gjeni në www.sapros.ch.

